## FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

### Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

PC STORE

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L01606034A

NUIS/NIPT

Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Tiranë | Albania | 1001 |
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Posta |

| | |
|---|---|
| 0685058344 | |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

info@pcstore.al

E-mail

Jurist Amarildo Arapi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| | |
|---|---|
| | 2023/04/20 |
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |

| | |
|---|---|
| 0696954369 | |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II: Informacion mbi procedurën**

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-65935-04-13-2023

| Tipi i proçedurës për ankesën | Tipi i ankesës |
| --- | --- |
| Procedure Prokurimi Publik | Dokumenta Tenderi |

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor qe administron procesin e prokurimit.*

Autoriteti Portual Durres

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

8398843

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuadër.*

Blerje kompjutera dhe Liçenca

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/04/24

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

*(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)*

---

Data e nënshkrimit të kontratës

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)*

---

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2023/04/24

Numri i njoftimit

CN/13250/04132023

Kodi CPV

31710000-6

Ankese mbi argument në KPP

---

**Seksioni III: Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza ligjore**

*(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)*

Ligji 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (LPP)
Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, i ndryshuar (Ligji për Sistemin Buxhetor)
VKM nr.285 datë 19.05.2021 "RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK (RrPP)
Rekomandimi Nr.7998 të datës 24.12.2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik
Jurisprudencë: Vendimi i GJED Çështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës"

---

**2. Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☑

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate ☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër ☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

Shoqëria PC STORE shpk është një shoqëri e themeluar e e organizuar sipas legjislacionit tregtar shqiptar dhe e ushtron aktivitetin në fushën e shitjes, eskpertizës, konsulencës, instalimit, konfigurimit të produkteve, shërbimeve, zgjidhjeve në fushën e IT, pajisjeve kompjuterike, pajisjeve të rrjetit, fotokopjimeve, sistemeve të rrjetit, serverave, Audio, UPS, etj.

Si një shoqëri tregtare PC STORE shpk e ushtron aktivitetin edhe në ofertimin tenderimin dhe lidhjen e kontratave publike sipas akteve normative në fushën e prokurimit publik në RSh.
PC STORE shpk ka një eksperiencë 13 vjecare në fushën e kontratave publike, në furnizimin e institucioneve dhe enteve publike me mallra, shërbime dhe zgjidhje të ndryshme në fushën e IT/ICT.

Autoriteti Kontraktor (AK) Autoriteti Portual Durrës, për nevojat e tij ka shpallur në portalin e prokurimit publik të APP, procedurën e prokurimit të llojit "Procedurë e hapur e thjeshtuar me nr : REF-65935-04-13-2023, me objekt "Blerje kompjutera dhe Liçenca" me fond limit 8.398.843 (tetë milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë, pa TVSH.

Shoqëria PC STORE shpk është një shoqëri e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë dhe po përgatit dokumentacionin teknik, ligjor, ekonomik dhe financiar konform kritereve të tenderit.

Këto kritere, në përgjithësi përbëjnë shkelje të legjislacionit dhe për këtë kemi paraqitur faktet dhe argumentat e mëposhtme.

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Pika 1.
Tek DST, Shtojsa 7 Formulari I Kritereve te Perzgjedhjes/Kualifikimit ,2,3 Kapaciteti teknike, nenpika:
2.3.5 Operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin Dokumentin e titulluar "Oferta Teknike" te ngarkuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tabele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:
a) Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
b) Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
c) Nr. i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluese.

Ankesa  per piken 1
Duke qene se tek DST Tek DST, Shtojsa 7 Formulari i Kritereve te Perzgjedhjes/Kualifikimit nuk eshte kerkuar  paraqitja e katalogeve dhe markimi i tyre, kerkojme modifikimin e pikes 2.3.5 ne :
2.3.5  Operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin Dokumentin e titulluar "Oferta Teknike" te ngarkuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tabele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen  rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:
a)  Emri  i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
Pika 2.
Tek DST, Shtojsa 7 Formulari I Kritereve te Perzgjedhjes/Kualifikimit ,2,3 Kapaciteti teknike, nenpika:
2.3.4  Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar, ku përfshihet një personel teknik që do të angazhohen në montimin e pajisjeve të ofertuara, si vijon:

a)  Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike/informatike "CompTIA IT Operations Specialist", ose ekuivalent.
b)  Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit "CompTIA Network Infrastructure Professional", ose ekuivalent.
c)  Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e programeve Office që do të ofertohen nga operatori ekonomik, ose ekuivalent.
Një punonjës mund të disponojë më shumë se një çertifikatë.
Për të vërtetuar stafin e mësipërm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:
?  Deklaratë për stafin përgjegjës
?  Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse
?  Listëpagesat sipas formularit E-Sig. 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.
Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me: Certifikatat /Transkriptet përkatëse
SI DHE Procesverbalit te Argumentimit ku ka cilesuar:

Argumentimi
Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:
1.  Për kriterin në pikën a), duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit është furnizimi dhe vendosja e pajisjeve kompjuterike të tipit Kompjuter, Monitor, Printer, Laptop, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike "CompTIA IT Operations Specialist".  për të siguruar instalimin e saktë të pajisjeve. Gjithashtu ky çertifikim siguron edhe suportin gjatë periudhës së garancisë. Zgjedhje për këtë çertifikim vjen pasi ai nuk lidhet me asnjë brand pasi është Vendor Neutral dhe ofron garanci që specialistët e çertifikuar do të mund të realizojnë punën e kërkuar.
2.  Për kriterin në pikën b), duke qenë se pajisjet objekt i procedurës së prokurimit do të instalohen, konfigurohen dhe punojnë në rrjetin kompjuterik të institucionit, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialistë të çertifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike "CompTIA Network Infrastructure Professional" për të garantuar konfigurim të saktë dhe për të siguruar suport gjatë kohëzgjatjes së garancisë. Zgjedhje për këtë çertifikim vjen pasi ai nuk lidhet me asnjë brand pasi është Vendor Neutral dhe ofron

garanci që specialistët e çertifikuar do të mund të realizojnë punën e kërkuar.
3. Për kriterin në pikën e) duke qenë se software objekt i procedurës së prokurimit janë 50 licensa Microsoft Office, është gjykuar që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e programeve Office. Kjo do të garantonte instalim të saktë të softuerit dhe mirëmbajtje gjatë gjithë periudhës së liçensimit.

Ankesa 1 per piken 3

APP në zbatim të misionit të saj, ka qenë konseguente në rekomandimet ndaj AK, konkretisht në Rekomandimin Nr.7998 të datës 24.12.2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik, faqja 4, pika 6 , paragrafi 2 i kësaj pike, rekomandon që, citoj:
Ndërkohë, në lidhje me informacionin dhe deklarimet që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të RRPP, autoritetet dhe entet kontraktore pranojnë këtë formular, të cilin operatorët ekonomikë e paraqesin bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, si një provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta.

Pra duke iu referuar parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Autoritetet Kontraktore do të duhet të pranojnë si provë paraprake deklaratat dhe vetëdeklarimet e operatorëve në vend të vërtetimeve.

Për të përfunduar me këtë pikë, kërkojmë që bëhen ndryshimet përkatëse, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kerkesa 1 :

Kërkojmë që të shtohet shënimi, si vijon:
Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave kualifikimit ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 12, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Përpara publikimit të njoftimit të fituesit operatori i renditur i pari duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e vetdeklaruar.

Kerkojme qe te zbatohet udhezimi i APP qe keto certifikime te plotesohen:
TEK Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit, B: DEKLARATË
Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)
Ankesa 2 per piken 3
Tek pika a) ku kerkohet:
Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike/informatike "CompTIA IT Operations Specialist", ose ekuivalent
Me argumentimin e AK-se:Për kriterin në pikën a), duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit është furnizimi dhe vendosja e pajisjeve kompjuterike të tipit Kompjuter, Monitor, Printer, Laptop, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike "CompTIA IT Operations Specialist". për të siguruar instalimin e saktë të pajisjeve. Gjithashtu ky çertifikim siguron edhe suportin gjatë periudhës së garancisë. Zgjedhje për këtë çertifikim vjen pasi ai nuk lidhet me asnjë brand pasi është Vendor Neutral dhe ofron garanci që specialistët e çertifikuar do të mund të realizojnë punën e kërkuar

Ky argumentim nuk qendron sepse kjo pengon konkurencen sepse vendosja e 1 (një) specialist të çertifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike ”CompTIA IT Operations Specialist”. për të siguruar instalimin e saktë të pajisjeve Kompjuter, Monitor, Printer, Laptop , kur kjo kontrate eshte Blerje Mallrave.
Nderkohe dhe Argumentimi mbi arsyjen pse eshte vendosur ky kriter nuk perpudhet me nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, konkretisht Neni 40 ,pika 6:
a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit p?rkat?s; dhe/ose
b) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
Në praktikat e prokurimit publik, duhet të shmangen kriteret që krijojnë kufizime në konkurrencë dhe duhet një studim tregu i mirëfilltë se cfarë kapacitetesh kanë operatorët në treg në raport edhe me nevojat e AK.
AK duhet të ketë parasysh në cdo rast se parimet e LPP, si pjesëmarrja e gjerë, konkurrenca mes operatorëve ekonomikë dhe integriteti i procedurës së prokurimit, janë postulate të padiskutueshme të integritetit dhe besimit në procedurat e prokurimit publik.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se cfarë duhet të ketë parasysh AK:

Neni 2
Qëllimi
Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3
Parime të përgjithshme
1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Të nxisë pjesëmarrjen, të nxisë konkurrencën, të mosdiskriminojë operatorët e tjerë dhe të mirëmenaxhojë fondet publike të vënda në dispozicion.

Vendosja e nje kriteri e nje specialisti te certifikuar me CompTIA IT Operations Specialist”per instalim mirembajtje kompjutera ,laptop eshte ne kundershtim me frymen e LPP-se dhe kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:

a) Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike/informatike.

Ankesa 2 per piken 3
Tek pika b) ku kerkohet:
Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit “CompTIA Network Infrastructure Professional”, ose ekuivalent

Kerkojme heqjen e ketij kriteri per arsyjen se ne asnje vend nuk kemi instalim dhe konfigurim pjisje Firewell,switch apo pajisje te ndryshme rrjeti.

Pika 3.
Tek DST eshte specifikuar
2.17. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po X Jo ?

Si dhe tek dokumenti _Procesverbali i Argumentimit _Kompjutera _Licensa , pika II. Argumentimi i specifikimeve teknike, eshte specifikuar:
Në përcaktimin e specifikimeve teknike për paisjet Kompjuter, Laptop dhe projektor janë vendosur parametra teknikë sipas standarteve të përcaktuara nga AKSHI.
Nderkohe po si me poshte nje tabele me specifikimet teknike te AK dhe specifikimet teknike te AKSHI-it( te vlefshëm për periudhën 1 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2024) referuar tek https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Standardet-TIK-2023-2024.pdf

F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net
Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 9500 Pikë 7900 Pikë
“RAM”: 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”: 500 GB SSD 500 GB SSD
“Disk Subsystem Controler”: Serial ATAIII 6 Gb/s Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”: Integrated graphic Card, min. 1 GB Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”: DVD+/-RW DVD+/-RW
“Slots”: Min. (2) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI
Portat e Komunikimit “Ports”: Min. (6) USB nga të cilat:
a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0
(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA Min. (6) USB nga të cilat:
a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0
(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti “Networking”: (1) 10/100/1000LAN Integrated Gigabit Ethernet Port (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”: Integrated Sound Card Integrated Sound Card
“Speakers”: Internal or Built-in Monitor Internal or Built-in Monitor

Siguria “Security Management”: Embedded Security TPM 2.0 Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: Windows 10 64-bit Professional OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”: Standart Keyboard QWERTY Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”: Minimum 3 Button Scroll Optical Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply” 220 V AC, 50 Hz 220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”: Energy Star Energy Star
AKSESORËT
Kabëll “Power Cord”: Po, European Po, European
“Recover”: Recover Partition Recover Partition
MONITORI
Tipi “Type”: LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”: = 23.6” = 21”
Rezolucioni “Native Resolution”: 1920 x 1080 at 60 Hz 1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”: 1000:1 1000:1
“Display Port”: (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”: = 6 ms = 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”: Energy Star Energy Star
Ushqimi “Power Supply”: 220 V AC, 50 Hz 220 V AC, 50 Hz
GARANCIA
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: 3 Vjet 3 Vjet

F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 11500 Pikë 11500 Pikë
“RAM”: 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size” 500 GB SSD 500 GB SSD
“Disk Subsystem Controler”: Serial ATAIII 6.0 Gb/s Serial ATA III 6.0 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”: Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor) Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
“Media Device”: DVD+/-RW DVD+/-RW
“Slots”: Min. (2) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI
Portat e Komunikimit “Ports”: Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone,
(1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor) Min. (6) USB nga të cilat:
a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0
(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone,
(1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”: (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”: Integrated Sound Card Integrated Sound Card
“Speakers”: Internal or Built-in Monitor Internal or Built-in Monitor

Siguria “Security Management”: Embedded Security TPM 2.0 Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: Windows 10 64-bit Professional OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”: Standart Keyboard QWERTY Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”: Minimum 3 Button Scroll Optical Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”: 220 V AC, 50 Hz 220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”: Energy Star Energy Star
AKSESORËT
Kabëll “Power Cord”: Po, European Po, European
“Recover”: Recover Partition Recover Partition
MONITORI
Tipi “Type”: LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”: = 27” = 21”
Rezolucioni “Native Resolution”: 1920 x 1080 at 60 Hz 1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”: 1000:1 1000:1
“Display Port”: (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”: = 6 ms = 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”: Energy Star Energy Star
Ushqimi “Power Supply”: 220 V AC, 50 Hz 220 V AC, 50 Hz
GARANCIA
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: 3 Vjet 3 VJET

F.V Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI
Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net: 18000 Pikë 12200 Pikë
“Chipset”: Intel ose Ekuivalent Intel ose Ekuivalent
“RAM”: 16 GB, min. DDR4 2666 MHz 16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”: = 500 GB SSD = 500 GB SSD
“Graphics”: Integrated Graphics with 1 GB Video Memory Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory
Ekrani “Display”: 14” - 16 2K LED/IPS, Anti Glare 15.6 FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”: Min. 60 Wh Min. 60 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI
Portat e Komunikimit “Ports”: Min. (2) porta USB nga të cilat min. (2) USB-C
(1) DP/HDMI
(1) Integrated Mic.
(1) Integrated HD Web Camera
(1/1)Headphone Jack Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1
(1) DP/HDMI
(1) Integrated Mic.
(1) Integrated HD Web Camera
(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”: Wireless 802.11ax (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V5; 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);
Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V4.1;

“Sound”: Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: Windows 10 64-bit ose ekuivalent OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera“Keyboard”: QWERTY QWERTY
“Pointing Device”: Touch Pad Touch Pad
AKSESORËT
Kabëll “Power Cord”: Po, European AKSESORËT
Ushqyesi “Recharger”: Po Po, European
“Recover”: Recover Partition Po
GARANCIA
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: 1 Vit 3 VJET

F.V Laptop Praktik

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 8700 Pikë 4900 Pikë
“Chipset”: Intel ose Ekuivalent Intel ose Ekuivalent
“RAM”: 8 GB DDR4 min. 2400 MHz 8 GB DDR4 min. 2400 MHz
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size” 256 GB SSD 256 GB SSD
“Graphics”: Integrated HD Graphics Integrated HD Graphics
Ekrani “Display”: 13 - 14 FHD LED (1920 x 1080), AntiGlare 13 - 14 FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”: Min. 45 Wh Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI
Portat e Komunikimit “Ports”: Min. (3) USB, ku të paktën (2) të jenë USB 3.0;
(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack;
(1) Integrated Web Camera;
(1) Integrated Mic.
(1) DisplayPort/HDMI Min. (3) USB, ku të paktën (2)të jenë USB 3.0;
(1/1)Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack;
(1) Integrated Web Camera;
(1) Integrated Mic.
(1) DisplayPort/HDMI
Rrjeti “Networking”: 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);
Wireless 802.11 ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V4.0; 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);
Wireless 802.11 ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V4.0;
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: Windows 10/1164-bit Professional OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera“Keyboard”: QWERTY QWERTY
“Sound”: Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
“Pointing Device”: Touch pad Touch pad
Siguria Security Trusted Platform Module TPM 2.0 Trusted Platform Module TPM 2.0
AKSESORËT
Kabëll “Power Cord”: Po, European Po, European
Ushqyesi “Recharger”: Po Po
Çanta “Carrying Bag”: Po Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe

Aksesorët e tjerë.
GARANCIA
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: 3 Vjet GARANCIA

Duke percaktuar se eshte referuar se eshte referuar specifikimeve te AKSHIT SHIKOJME SE KEMI KETO NDRYSHIME DHE KONKRETISHT:

I. F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net
Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 9500 Pikë 7900 Pikë

Sic shikohet ka nje ndryshim piket procesori nga 7900 pike ne 9500 pike prandaj kerkojme sqarim :

a) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t
b) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
c) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 1
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga 9500 pike ne 7900 pike

II. F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

“Slots”: Min. (2) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16

Sic shikohet ka nje ndryshim “Slots”: nga Min. (3) PCI/PCI-E ne Min. (2) PCI/PCI-E prandaj kerkojme sqarim :

1. Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
2. Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
3. Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 2
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga Min. (2) PCI/PCI-E ne Min. (3) PCI/PCI-E

III. F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Madhësia “Size”: = 23.6” = 21”

Sic shikohet ka nje ndryshim MADHESIA nga = 21”ne = 23.6 prandaj kerkojme sqarim :
4. Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
5. Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
6. Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 3
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga = 23.6 ne = 21

IV. F.V Njesi Qendrore + Monitor Tipi 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Madhësia “Size”: = 27” = 21”

Sic shikohet ka nje ndryshim MADHESIA nga = 21”ne = 27”prandaj kerkojme sqarim :
7. Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
8. Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
9. Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 4
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga = 27 ne = 21

V. Njesi Qendrore + Monitor Tipi 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

“Slots”: Min. (2) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16

Sic shikohet ka nje ndryshim “Slots”: nga Min. (3) PCI/PCI-E ne Min. (2) PCI/PCI-E prandaj kerkojme sqarim :
10. Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
11. Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
12. Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 5
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga Min. (2) PCI/PCI-E ne Min. (3) PCI/PCI-E

VI. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net
Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 18,000 Pikë 12,200 Pikë

Sic shikohet ka nje ndryshim piket procesori nga 12,200 pike ne 18,000 pike prandaj kerkojme sqarim :
d) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
e) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
f) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 6
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga 18,000 pike ne 12,200 pike.

VII. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

"Graphics": Integrated Graphics with 1 GB Video Memory Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory

Sic shikohet ka nje ndryshim Karta Grafike TE DEDIKUAR nga min.4 GB ne Karte grafike te integruar 1 GB prandaj kerkojme sqarim :
g) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
h) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
i) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.
j) AK ka info qe karta e Dedikuar ka nje ndryshim te madh si ne performance por edhe ne cmim me karten e integruar .

Ankesa 7
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga Karte grafike te integruar 1 GB ne Karta Grafike TE DEDIKUAR nga min.4 GB.

VIII. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Ekrani "Display": 14" - 16 2K LED/IPS, Anti-Glare15.6 FHD LED (1920 x 1080), Anti-Glare

Sic shikohet ka nje ndryshim te madhesise nga 15.6 ne 14-16 2K LED/IPS ,prandaj kerkojme sqarim :
k) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
l) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
m) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.
n) Pse duhet teknologjia 2K LED/IPS

Ankesa 8
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga 14-16 2K LED/IPS ne 15.6 FHD LED.

IX. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Portat e Komunikimit “Ports”: Min. (2) porta USB nga të cilat min. (2) USB-C
(1) DP/HDMI
(1) Integrated Mic.
(1) Integrated HD Web Camera
(1/1)Headphone Jack Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1
(1) DP/HDMI
(1) Integrated Mic.
(1) Integrated HD Web Camera
(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack

Sic shikohet ka nje ndryshim te numrit te portave nga Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 ne Min. (2) porta USB nga të cilat min. (2) USB-C, prandaj kerkojme sqarim :

o) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,

p) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .

q) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 9
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga Min. (2) porta USB nga të cilat min. (2) USB-C ne Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 .

X. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Rrjeti “Networking”: Wireless 802.11ax (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V5; 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);
Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);
Bluetooth min. V4.1;

Sic shikohet ka nje heqje te numrit te portave te rrjetit nga 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); prandaj kerkojme sqarim :

r) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,

s) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .

t) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 10
Kerkojme modifikimin dhe vendosjen e specifikimit 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);

XI. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: Windows 10 64-bit ose ekuivalent OEM Windows 10 64-bit Professional

Sic shikohet ka nje ndryshim te Sistemit Operimit nga OEM Windows 10 64-bit Professional ne Windows 10 64-bit ose ekuivalent, prandaj kerkojme sqarim :
u) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
v) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
w) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 11
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga Windows 10 64-bit ose ekuivalent ne OEM Windows 10 64-bit Professional .

XII. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty": 1 Vit 3 VJET

Sic shikohet ka nje ndryshim te Periudhes se Garancise nga 3 VJET ne 1 VIT, prandaj kerkojme sqarim :
x) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
y) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
z) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 12
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi garancia nga 1 VIT NE 3 VITE
XIII. Laptop PRAKTIK

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE TE VENDOSUAR NGA AK Autoriteti Portual Durres AKSHI

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net
Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 8700 Pikë 4900 Pikë

Sic shikohet ka nje ndryshim piket procesori nga 4,900 pike ne 8,700 pike prandaj kerkojme sqarim :
?) Pse jane ndryshuar specifikimet teknike te AKSHI-t,
?) Per percaktimin e fondit limit te procedures jeni bazuar tek cmimet e publikuara te AKSHI-t .
?) Keni kryer testim tregu me keto specifikime te kerkuara.

Ankesa 13
Kerkojme modifikimin e ketij specifikimi nga 8,700 pike ne 4,900 pike.

Në praktikat e prokurimit publik, duhet të shmangen kriteret që krijojnë kufizime në konkurrencë dhe duhet një studim tregu i mirëfilltë se cfarë kapacitetesh kanë operatorët në treg në raport edhe me nevojat e AK.

AK duhet të ketë parasysh në cdo rast se parimet e LPP, si pjesëmarrja e gjerë, konkurrenca mes

operatorëve ekonomikë dhe integriteti i procedurës së prokurimit, janë postulate të padiskutueshme të integritetit dhe besimit në procedurat e prokurimit publik.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se cfarë duhet të ketë parasysh AK:
Neni 2
Qëllimi
Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3
Parime të përgjithshme
1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21
Autoriteti ose enti kontraktor
1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 87
Kriteret për shpalljen e ofertës fituese
4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Dhe neni 45 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, citoj;

Neni 45
Kriteret për shpalljen e ofertës fituese
6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen,

për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Po ashtu vendosja e këtyre kritereve përbën një shkelje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 13, neni 14, citoj:

Neni 13
Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë
Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14
Parimi i objektivitetit
Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën admini-strative.

Autoritet Kontraktore duhet të marrin parasysh që procedurat e tenderit duhet të jenë të formuluara në një formë që të nxisin konkurencës e lirë mes operatorëve, sic përcakton edhe vendimi i GJED Çështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike.
Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese."

Duke iu referuar një ndër qëllimeve kryesore të ligjit ku parashikohet se eficenca, efikasiteti dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, konkretisht neni 2, citoj:

Neni 2
Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
janë postulate të padiskutueshme në referim të këtij ligji, Autoritetet Kontraktore duhet të mbajnë parasysh që të prokurojnë mallra shërbime punë në mënyrë sa më efikase duke përfituar një cmim sa më të ulët.

Dhe cmimet e ulta dhe konkuruese e bën një procedurë ku ofron shance të barabarta për të gjithë ofertuesit e mundshëm, pra duke mos aplikuar kritere përjashtuese, kritere që nuk kanë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit dhe/ose kritere që orientohen drejt një ofertuesi të caktuara apo një grupi ofertuesish, që automatikisht kufizon konkurrencën, rrjedhimisht duke bërë që të ofrohen cmime më të larta.

Kjo sjellje bie ndesh edhe me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, konkretisht Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se institucionet duhet të kenë parasysh përdorimin eficent të fondeve publike, konkretisht neni 3 dhe neni 4 i ligjit, citoj:

Neni 3
Përkufizime
Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Buxhet" është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë "Kuvendi" ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4
Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor
Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:
ç) përdorimi ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike;

ku përcaktimi në ligj është shterues që është detyrë kryesore e intitucioneve mirëmenaxhimi i fondeve publike. Në këtë kuptim, AK, duke kufizuar konkurencën, automatikisht keqmenaxhon edhe fondet publike.

Për të konkluduar PC STORE shpk në vazhdim të arsyetimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.

2. Të modifikohen kriteret sipas kërkesave tona.

3. Të modifikohen specifikimet teknike të tenderit sipas kërkesave tona.

4. Modifikimin e dokumentave të tenderit.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po ☐ Jo ☑

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

jo

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

Informacione teknike dhe ekonomike qe nuk gjenden ne regjistra publike.

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:** info@pcstore.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

Amadio Arapi

Digitally signed by Amadio Arapi
Date: 2023.04.20
03:00:13 +02'00'

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar** Vitator Mehmeti